

# **FJALA E Z. BESNIK DERVISHI, KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, NË WORKSHOP “CLOUD COMPUTING DHE MASAT E SIGURISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”**

HOTEL TIRANA INTERNACIONAL  
26 qershor 2015

Zhvillimet e shpejta të teknologjisë së komunikimit dhe sistemeve të IT-së krijojnë arkiva të dhënash për përdorime të ndryshme, duke rritur nga ana tjetër edhe mundësitë e një sjellje abuzive me të dhënat personale.

Përdorimi masiv i Internetit bën të mundur që kushdo të përdorë sot shërbimet e cloud computing.

Përditësimi i profilit në Facebook, vendosja e fotografive në Instangram, ngarkimi i të dhënave në një data baze online, janë të gjitha mënyrat e përdorimit të cloud computing, shërbim i cili është me rëndësi për bizneset moderne.

Kështu, ata mund të zvogëlojnë në mënyrë drastike shpenzimet e tyre operative. Ky koncept e bën të mundur që edhe kompanitë e reja start-up të hyjnë në tregjet e mëdha pa rrezikuar.

Në të ardhmen, cloud computing do të ketë edhe më shumë përdorim dhe për këtë arsye, duhet që sot të marrim masa organizative për të mbrojtur të dhënat personale, duke ndërmarrë të gjitha hapat ligjore dhe jo vetëm, për të ofruar siguri nga humbja, shkatërrimi, ndërhyrja apo vjedhja e të dhënave personale.

**Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit rrit qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale.**

**Mbrojtja e privatësisë mund arrihet me përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme të teknologjisë së informacionit, pasi si kompanitë ashtu dhe qytetarët presin që kjo infrastrukturë të jetë në dispozicion dhe funksionale në çdo kohë dhe në çdo vend, në mënyrë që të dhënat mund të përpunohen dhe të ruhen në mënyrë të sigurtë.**

**Kjo është një çështje globale, e cila reflektohet edhe në vendin tonë dhe kërkon monitorim konstant dhe veprime konkrete. Partnerët tanë po kërkojnë me shumë forcë sisteme të garantuara dhe ndërkohë, krijimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet Autoriteteve të mbrojtjes së të dhënave.**

Për këtë arsye jemi mbledhur dhe sot në këtë tavolinë të rrumbullakët, për të diskutuar rreth këtij zhvillimi teknologjik.

Do ju vendosim ne dispozicion edhe një pyetësor për të kuptuar nivelin e përdorimit të këtij shërbimi dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave personale.